



**Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit**



01/Nr. 2737 /2021  
Data: 12.04.2021

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 16.03.2021 me fillim pune në ora 10:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyryetar i Komunës), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.
3. Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2020.
4. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020.
5. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i kërkesës së z.Ramush Krasniqi.
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të cilat i kemi paraparë në agjendë i kemi edhe dy pika shtesë që do të përcillen për kuvend. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale. Për pikat shtesë dhe për rendit e punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.
3. Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2020.
4. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020.
5. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i kërkesës së z.Ramush Krasniqi.
7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019.
8. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
9. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- faqe katër në vend të fjalës përgjesohen të përmirësohet dhe të jetë përgjithësohen. Në faqen pesë në vend të fjalës përgjigjsohen të përmirësohet dhe të jetë përgjithësohen.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLËDHJA E KALUAR**

## **2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- komitetit për komunitet i ka mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje për vitin 2020. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- pengesat të cilat janë vendosë në trotuar te ambulanta kemi kërkesa për me i hequr dhe a është konsultuar komiteti për komunitet sepse kjo hynë si punë e tyre e së paku është dashur me u konsultuar me komitetin për komunitete për shkak se janë në kontakt me komitetin. Ka kërkesa nga qytetarët që me u hequr por nuk e di se nga kush është marr ky vendim për shkak se janë pengesë. Është pengesë për qytetarët të cilët shkojnë në ambulantë për me kryer shërbime sepse nuk kanë ku me i lënë automjetet. Është mirë që të shqyrtohet kjo çështje.

**Kryesuesi** thekson:- kjo pikë mund të hynë dhe të diskutohet në komiteti për komunitet dhe te komiteti për zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe mbrojtje të ambientit. Diskutime ka për edhe kundër por pengesat duhet të hiqen, mirëpo është një arsyetim që automjetet me u parkuar te parkingu i komunës që është mbrapa.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- më mirë do të ishte me u hequr, e kushdo mund ta vjen te komuna me parkuar veturën, ndërsa nëse shkon një qytetarë dhe e parkon veturën mbrapa komunës në parking është problem dhe ndoshta mund të ecë por ka raste tjera që nuk mund të ecin dhe ndoshta duhet me i mbajtur për krahu është pak keq. Është mirë me shqyrtuar edhe një herë këtë vendim kushdo që e ka marr sepse realisht është pengesë për qytetarët.

**Teuta Shkreta** thekson:- unë dhe shumë kolegë të mi ka pas raste që kanë mundur me goditur ndonjë kalimtarë me veturë. Unë kam menduar që kufizimi i trotuarit ka menduar që do të bëhet deri në krye për shkak se po bllokohet trotuari.

**Kryesuesi** thekson:- ne mund ta marrim shembull emergjencën në Ferizaj sepse unë e bi rastin e shpejtë veturën duhet me parkuar dikund apo mundem me ndalë në rrugë dhe ma pengesë ka me bërë për shkak se nuk kam mundësi me dërguar diku tjetër. Kjo duhet të shqyrtohet në mënyrë profesionale.

**Mallzum Qajani** thekson:- ato parkingje nuk kanë qenë të planifikuara as të vendosura. Ambulanta kur i ka bërë nuk e ka pyetur askënd por vetëm i ka shënuar dhe realisht flasim më shumë rrinë veturat e punëtorëve të ambulantes se sa të tjerëve që bëhet pengesë për qarkullimin e udhëtarëve. Hapësirë për me hyjnë për një veturë apo dy ka për raste emergjente. Ka raste që qytetarët e parkojnë veturën aty dhe dalin e pinë kafe.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- personalisht pata punë në ambulantë dhe parkova veturën diku por ka qytetarë të ndryshëm që kanë probleme më të mëdha. Për punëtorët e QKMF-së zgjidhja më e mirë do të ishte me i parkuar vetrat mbrapa objektit të komunës dhe aty me planifikuar një parking për pacientët dhe herë pas here me i kontrolluar edhe inspektorati i komunës dhe policia sepse nuk ka logjik nëse dikush e parkon vetrën dhe del pinë kafe. Është mirë me i shikuar mundësitet që me e zgjeruar pjesën e ambulantes edhe për një metër në mënyrë që me bërë zgjidhje.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 3. Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- komitetet konsultative kanë planifikuar me i mbajtur nga gjashtë mbledhje, mirëpo dy komitetet i kanë mbajtur nga gjashtë mbledhje dhe dy komitetet nga pesë mbledhje. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 4. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- këshilli për siguri në bashkësi zakonisht i mbanë mbledhjet të premtën e fundit të muajit. Temat që diskutohen janë siguria në komunë dhe aktualitet që përshkojnë muajin përkatës. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 5. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- këshillat lokale nuk kanë paraqitur raport sa i përket aktiviteteve për shkak se nuk janë aktive sepse ju ka skaduar afati në muajin prill të vitit 2020. Për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me i zhvilluar procedurat për zgjedhjen e tyre. Sipas rregullores të cilën e ka miratuar kuvendi që është e bazuar në udhëzim administrativ nuk kemi të drejtë me i pasur 13 këshilla lokale siç i kemi pasur dhe sipas numrit të banorëve që i ka komuna e Hanit të Elezit duhet të zgjidhen vetëm katër këshilla lokale të fshatrave. Deri në momentin që do të bëhet lirimi i masave këshillat do të janë pasive. Për zgjedhja e këshillave lokale do të fillohet në momentin që do të bëhet lirimi i masave. Përveç shkresës njoftuese të cilën e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA NJOFTIMI PËR AKTIVITET E KËSHILLAVE LOKALE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

##### **6. Shqyrtimi i kërkesës së z.Ramush Krasniqi.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- deri më tani komuna e Hanit të Elezit nuk ka pasur kërkesa për këto pika në Kodër Stanit dhe ajo pjesa ka Gorancë Kodra e Frashrit. Komuna ka pasur dilema në lidhje më këtë sepse kërkesat janë bërë për sipërfaqe shumë të mëdha dhe nuk ka pasur ndonjë ide deri në fund se çka donë me bërë me këtë. Na kemi pritur që me planin zhvillimorë do të rregullohet por plani po vonohet për shkak të pandemisë që nuk kemi mundur me i zhvilluar procedurat dhe kemi menduar që komuna të kufizohet në hapësira dhe sa do të jetë hapësirë për kuvend do tu a përcjellim një raport të një komisioni që do të del me informata detale.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk i kemi penguar askujt për pëlqime dhe nëse thuhet që duhet të ketë kritere pajtohem që duhet të ketë kritere kur t'i japim pëlqim dikujt për shkak se mund të dalin telashe dhe potencojnë që kuvendi e ka dhënë por komuna i përcakton kushtet. Unë jam pro që ti ipet pëlqimi.

**Sabedin Hasallari** thekson:- u potencua që sipërfaqe madhe kërkohet dhe nëse është përbiznes sa sipërfaqe kërkohet.

**Mallzum Qajani** thekson:- komuna e ka për bazë që këto janë pika strategjike dhe ato male nuk guxojmë të preken dhe të dëmtohen. Komuna është e interesuar që këto vende të bëhen turistike për zhvillim turizmit por duke e ruajtur atë themelore që është mali duke i kufizuar ndërtimet që do të bëhen duke ju përshtatur rrethanave për zhvillim të turizmit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- duhet të shikohet se a bien ndeshë me planin zhvillimorë të komunës, ndërsa sa i përket sipërfaqes është pronë e ekonomisë së pyjeve. Komuna i jep pëlqim dhe nëse e parashev plani zhvillimorë që nuk mund t'i japim komuna nuk i jep.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA KËRKESA E RAMUSH KRASNIQI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

##### **7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë u dakordua që të hynë në rendë të punës dhe për mbledhje të kuvendit do të përcillet edhe materiali.

##### **8. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë u dakordua që të hynë në rendë të punës dhe për mbledhje të kuvendit do të përcillet edhe materiali.

**9. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në ora 10:35

Procesmbajtësi

Avm Bushi

